

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Analiza - Ekonomia ecën mirë vetëm për atë që ka një koncesion, për të tjerët është provë mbijetese
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917796/ekonomia-ecen-mire-vetem-per-ate-qe-ka-nje-koncesion-per-te-tjeret-eshte-prove-mbijetese/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 09:51:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 09:32:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5696b2bc1de8fad319b5638ee850a6f6fd2af1e0cfcbe165b5ddebf139288d31
TEKSTI	3992b7b574649e830c4e401af62eb67ee97ce5812f2244781b440e51e3c1d742
PAMJA	d1d7679eabe7cee1e7fc2c283cfff76804ebcc662e13d73506dece0575e44b10f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	640f7b68dbf88ed73082df72ab4f888eb5b8694040a9788e4074f26e4c6eb041
E MËPARSHMJA	746112f08ac74dde6ce1db186349aabea943bb6a8da50fa00c5c2328ecc64e51
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/640f7b68dbf88ed73082df72ab4f888eb5b8694040a9788e4074f26e4c6eb041>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NDRIÇIM KULLA
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit
siamezë të dekadencës
demokratike evropiane



PROF. MYQEREM TAFAJ
Shqipëria e harruar fillon aty
ku shkolla mbetet pa nxënës!

LAJMI I FUNDIT

Kurti: Është konfirmuar identiteti i tri viktimave nga varret masive në Zubin Potok, i përkasin 'Grupit të Intelektualëve'



më të lexuarat

'Akuza të stisura politikisht', Saiti:
Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të
Kosovës

Specialja: Të akuzuarit vepruan së
bashku për një qëllim të përbashkët
kriminal, Thaçi ishte anëtar kyc

Takimi sekret i DEA-s me vendet e
Amerikës Latine/ Si po i damkos
shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës

By Pass i Elbasanit/ 'Karakaçi në rrugën
e Balllukut', Himci: S'dihet kur do
përfundojë, tenderat po vidhen

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli
mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Ligji për statusin e magistratëve të hiqet
nga rendi i ditës, Bardhi denoncon



Ekonomia ecën mirë vetëm për atë që ka një koncesion, për të tjerët është provë mbijetese

11:32, 19/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Irena Beqiraj

Qeveria vazhdon të na sigurojë se ekonomia po ecën mjaft mirë. Kjo gjë është teknikisht e vërtetë vetëm nëse zotëron ndonjë kontratë koncesioni, port apo aeroport; nëse je furnizues pa garë i shërbimeve tek AKSHI, apo furnizuesi me makina a veshje i ushtrisë; nëse zotëron ndonjë kazino; ose nëse je furnizuesi i vetëm në treg për ilaçet kundër ankthit.

Për të gjithë të tjerët, ecuria e mirë ekonomike tingëllon teorike. Edhe nuk po bëj as politikë, as kritikë, thjesht një përshkrim të asaj që një shqiptar i zakonshëm, pa pushtet ekonomik apo politik, përjeton çdo ditë.

Papunësia është ulur, por shqiptarëve u duhet të punojnë dy punë për të përballuar privilegjin e blerjes së ushqimeve, një pjesë e të cilave, megjithëse gjenden nëpër raftet e dyqaneve, u ngjajnë xhevahireve të rralla në një ekspozitë muzeale.

Në Shqipëri, një paketim me 10 vezë kushton 3,9 euro, ndërsa në Europë, mesatarisht, kushton 3 euro.

Një litër qumësht i zakonshëm në Shqipëri kushton 1,9 euro, çmim ky dukshëm më i lartë se mesatarja e tij në Bashkimin European.

Sipas të dhënave më të fundit të Eurostat-it, kostoja e kombinuar e produkteve të qumështit, mishit dhe vezëve në Shqipëri është rritur ndjeshëm, duke arritur në 35,6% mbi mesataren e BE-së. Perimet dhe frutat, po ashtu, janë më të shtrenjta

se në BE.

Ndaj, çdo vizitë në supermarket, për një familje me të ardhura mesatare, është kthyer në një ngjarje të rëndësishme financiare dhe, si e tillë, çdo dalje për pazar kërkon një mbledhje urgjente familjare.

Por shpresa vdes e fundit.

Janë çmimet e karburanteve që luhaten, si për të na e mbajtur atë gjallë. Ato bien me pesë lekë, për të mos vrarë njëherë e mirë optimizmin tonë, dhe më pas rriten me njëzet lekë, si për të na kujtuar se, për çmimin e karburantit, vazhdojmë me kokëfortësi të kryesojmë renditjen në Europë.

Ndërkohë, edhe strehimi ka evoluar. Nga një domosdoshmëri bazë është kthyer në një ëndërr të çmuar, njëlloj si dalja në pension apo arritja e paqes së brendshme. Të rinjtë tani flasin për pronësinë e një shtëpie në të njëjtën mënyrë siç flisnin fshatarët mesjetarë për mundësinë për t'u bërë mbretër. Si froni dikur, edhe banesa sot mund të arrihen ose si trashëgimtarë, ose me ndërhyrjen hyjnore.

Ndërsa një sëmundje, dhëntë Zoti të mos jetë e gjatë dhe e vështirë, sepse më shumë se 43% e shqiptarëve mund të kthehen sa hap e mbyll sytë në të varfër.

Pagat, natyrisht, janë rritur, por jo me të njëjtin vull entuziast siç ka ndodhur me çmimet apo fitimet e 200 kompanive më të mëdha. Ndërsa paga mesatare e shqiptarit të thjeshtë ecën me ritmin e një burri të moshuar, rritja e çmimeve, paga e deputetit dhe fitimet e kompanive janë të shpejta si një atlet profesionist njëzetvjeçar.

Por shqiptarët duhet të dëgjojnë edhe t'i gëzohen lajmit se "ekonomia është e fortë dhe e qëndrueshme, edhe se leku është forcuar". Ndaj socialistët i përsërisin këto vazhdimisht.

Veçse kjo qëndrueshmëri vetëm në statistika e ka kthyer jetën në Shqipëri në një sprovë gjigante rezistence, ku qytetarët gjenden pa mbrojtje ndaj rritjes së pakontrolluar të faturave dhe ku "klasa e mesme" nuk është më një kategori sociale, por një referencë historike nostalgjike.

Për zbutjen e kostove të jetesës, qeveria ka 13 vjet që rrotullon pa rezultat të njëjtat programe e ide (borde, pasqyra, programe strehimi). I rrotullon në të njëjtën mënyrë siç rrotullojmë çdo darkë Listerinën në gojë, për të parandaluar shpërthimin e ndonjë revolte akute, por kurrësi për të adresuar problemin.

Qeveria dhe institucionet nuk po ndërhyjnë në shkaqet strukturore: mungesën e konkurrencës, informalitetin, zinxhirët e furnizimit, funksionimin e tregjeve dhe korrupsionin. Në mënyrë qesharake, rikthehet e njëjta retorikë e ndërhyrjes administrative te shitësit e pakicës, kur fitimet shkojnë te monopolet dhe oligopolet e shumicës.

Ndaj, këto programe mund t'i zbusin kostot e jetesës aq sa parashikimi i motit mund të zgjidhë zinë e bukës.

Edhe kjo është gjëja më qesharake e politikës. Flasin për koston e jetesës sikur ajo të ishte ndonjë studim statistikor dhe jo halli më i madh i përditshmërisë së shqiptarit.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Kurti: Është konfirmuar identiteti i tri viktimave nga varret masive në Zubin Potok, i përkasin 'Grupit të Intelektualëve'



Berisha: Procesi i Ripërtëritjes sonë, është një proces jetik për Ripërtëritjen e Shqipërisë



Këlliçi: Edi Rama, 12 ditë heshtje për koordinatorin e punëve të pisëta, Ron Yeffet!

skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...



'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi



Bardhi - Ramës: Po hakmerresh ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve se të trokitën në derë për aferat ku je zhytur



'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

TË NGJASHME



Kandidatet e zgjedhjeve lokale/

Berisha: Personalisht jam për primaret me seleksion



Berisha: Ata që votojnë për bashkimin e Matit me Klosin bëjnë akt tradhtie të shëmtuar ndaj qytetarëve

Berisha: Ne po punojmë për zgjedhjet lokale, por duhet të shpejtojmë në këtë drejtim



Berisha: Nuk lloboj unë për ndalimin e vizës së Ramës, por do bëj gjithçka që të përballim me drejtësinë

Berisha: Kërkohet të punohet për kryesorin e PD, do bëjmë gjithçka që të bëhet realitet



Berisha: Bajram Begaj ka plaçkitur pronën dhe i ka ndarë me Ramën, atë e kap gjyqi ushtarak

Muzeu neolitik në vllot/ Berisha: E quaj pozitive, PD është parti e tolerancës fetare

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.